

## INFORMATOR

### Puna Praktike

Programi i punës praktike në kuadër të Kolegjit Universitar Universum u zhvillua për të mundësuar dhe inkurajuar studentët që të angazhohen në një përvojë profesionale të të mësuarit përtej ligjëratave në klasë. Konsiderojmë se puna praktike do të ofrojë mundësi për studentët që të përfitojnë përvojë dhe zhvillojnë më tutje aftësitë e tyre në një mjedis profesional.

Puna praktike nuk duhet të perceptohet si një punë afatshkurtër që gjithsesi duhet përfunduar, por si një përvojë e vlefshme e të mësuar të gjërave në praktike dhe si mundësi për punë afatgjate.

#### Çka përfiton studenti nga puna praktike?

- Zhvillim intelektual, profesional dhe etik;
- Eksplorim mundësish për zhvillim të mëtutjeshëm në karrierë;
- Përfitim i aftësive të reja ndërpersonale dhe profesionale;
- Eksperiencë në punë;
- Krijim të një rrjeti profesional;
- Vlerësim me kredi;

#### Çka përfiton kompania/institucioni nga puna praktike e studentit?

- Ide dhe zgjidhje të reja për problemet e vjetra;
- Mundësi për të rekrutuar punonjës profesional;
- Punëtor fleksibil me kosto të ulët;
- Mundësia për të zhvilluar projekte të reja;
- Studentë të motivuar, të gatshëm për punë dhe të shkolluar;

#### Çka kualifikohet si punë praktike?

Universum mundëson punën praktike për të gjithë studentët e vitit të dytë dhe të tretë, në drejtimet: Banka dhe Financa; dhe Administratë Publike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare. Qëllimi kryesor i punës praktike është të sigurojë se studentëve u është ofruar mundësia për tu zhvilluar më tej profesionalisht. Puna praktike duhet të jetë e mbikëqyr, e cilësisë së lartë dhe e ndërlidhur me fushën e studimeve.

Nga puna praktike duhet të përfitojnë studenti, por në të njëjtën kohë edhe kompania/institucioni. Në mënyrë që të arrihen përfitime të ndërsjella, puna praktike duhet të strukturoret qartë, të paraqiten objektivat e mësimit dhe në fund të bëhet vlerësimi nga të dy palët.

Punë praktike konsiderohet:

- **Zhvillim i projektit** – studenti në bashkëpunim me zyrën e karrierës shkruan projektin dhe zhvillon atë gjatë semestrit. Idea e projektit duhet të konsultohet edhe me ligjëruesin e lëndës përkatëse.
- **Asistencë profesionale** – studenti asiston në punët e përditshme të personit që ka pozitë udhëheqëse në kompani/institucion.
- **Punëtor i ri** – studenti punësohet në kompani/institucion për një pozitë të caktuar dhe i përcaktohen përgjegjësitë

- **Puna në disa departamente-** studentit i kërkohet që të ofrojë ndihmë në disa departamente të ndryshme në mënyrë që të njihet me funksionimin e përgjithshëm të organizatës/institucionin.

**Si do të përfitoj kreditë:**

Për të fituar kreditë e parapara për punë praktike, ju duhet të siguronit zyrën e karrierës dhe drejtorin e departamentit të drejtimit tuaj se keni përfunduar me sukses punën praktike. Për ta bërë këtë, ju duhet të plotësoni këto dokumente:

- Informatat bazë;
- Vlerësimi nga studenti për punën praktike;
- Vlerësimi nga punëdhënësi për punën praktike;

Këta formularë mund ti gjeni në zyrën e karrierës.

Kreditë për punë praktike do të fitohen vetëm nëse i keni plotësuar formularët e lartë cekur dhe nëse keni marrë miratimin nga zyra e karrierës dhe drejtori i departamentit të drejtimit tuaj.

**Si të gjej mundësi për punë praktike?**

Zyra e karrierës në kuadër të Universum do ju njoftojë në baza ditore lidhur me mundësitë e fillimit të punës praktike. Lajmërohu në zyrën e karrierës nëse:

- Dëshiron të fillosh punë praktike por nuk i di mundësitë;
- Dëshiron të zhvillosh një ide për projekt;
- Ke identifikuar mundësitë për punë praktike;
- Ke përfunduar punën praktike, dëshiron të përfitosh kreditë;

**Universum ofron këto shërbime për Ju, shfrytëzoje mundësinë që të zhvillosh profesionalisht dhe të kesh një punë në të ardhmen.**

**Lajmërohu në Zyrën e Karrierës:**

Ulpiana Campus

Tel: +381 38 555 315

[zyrakarrieres@universum-ks.org](mailto:zyrakarrieres@universum-ks.org)

[www.universum-ks.org](http://www.universum-ks.org)